

RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: SISTEMIM DHE ASFALTIM I
RRUGES 'ALI ÇEKA'**

BASHKIA PEQIN

2019

HYRJE

Hartimi i projekt zbatimit, së objektit: “Sistemim asfaltimi I rruges “Ali Çeka”, bëhet me qëllim që të realizohet rikonstruksioni i kësaj rruge ekzistuese.

Përcaktimi dhe zgjedhja e masave të ndërhyrjes në objekt u mbështet në gjendjen ekzistuese të tij dhe materialet ekzistuese të ofruara nga Institucionet përkatesë.

Të gjithë informacionet , grupi i projektimit bëri azhurnimin në vend të objektit në fjalë, duke bërë plotësimet e nevojshme të studimit topografik, vlerësimit ambiental etj. Pas kësaj u bë një analizë e detajuar për zgjidhjen e projektit të zbatimit të rrugës ekzistuese. Rezultatet pasqyrohen në vizatime dhe në raportin teknik dhe në raportet e llogaritjes që përmban:

U konstatua se mungojnë elementet kryesor të objektit dhe në këto kushte del i nevojshme rikonstruksioni i saj . Rruga me gjatësi rreth, $L=165$ m, është pjesë e segmentit rrugor që shtrihet në qendrën Qytetit të Peqin-it. Kësaj rruge i mungojnë elementet arkitektonike dhe ndërtimore. Ka një rrjet të kanalizimit të ujërave të zeza krejtësisht jashtë funksioni dhe nevojitet përmirësimi i ndricimit.

Analiza e rruges ekzistuese:

Të gjithë informacionet , grupi i projektimit bëri azhurnimin në vend të rrugës në fjalë, duke bërë plotësimet e nevojshme të studimit topografik, vlerësimit ambiental, Pas kësaj u bë një analizë e detajuar për zgjidhjen e projektit të zbatimit (draft) të Rrugës ekzistuese. Rezultatet pasqyrohen në vizatime dhe në raportin teknik dhe në raportet e llogaritjes që përmban:

Të dhëna shtesëmbi gjendjen e rruges ekzistuese, të dhëna shtesë mbi gjendjen e shkarkimeve të ujërave të bardha, të dhëna shtesë për gjeologjinë dhe gjeoteknikën e objektit. Vizatimet digjitale të rrugës.

Vlerësimi i gjendjes së rrjetit ekzistues të ujërave të bardha.

Vlerësimi i kapaciteteve të tombinove, etj.

Vlerësimi kushteve të punës të sistemit (kushtet e mirëmbajtjes, mbushjet nga mbeturinat,) etj. Azhurnim i gjendjes fizike të veprave të artit dhe kushteve që duhet të meren. Identifikimi dhe klasifikimi i demtimeve.

Difektet strukturale të veprave të artit.

Kerkesat për mirëmbajtje.

Kapaciteti i tubacioneve ekzistuese. Vlerësimi, ndërhyrja në veprat e artit.

U konstatua se mungojnë elementet ndërtimore të rrugës dhe në këto kushte del e nevojshme ndërtimi i saj

-Përshkrimi i projektit.

Sistemim asfaltimi I rrugës “Ali Çeka” parashikon të rikonstruktohet e gjithë struktura , sepse është e amortizuar dhe ndër vite nuk ka patur ndërhyrje mirëmbajtjeje në të. Gjatesi e rruges është tek 165 m dhe kufizohet nga njëra anë e saj me murin rrethues të dy shkollave .

Rikonstruksioni parashikon ndërhyrje si:

-Prishje dhe rialokime

Rruga “Ali Çeka është një ndër rrugët më të rëndësishme të qytetit. Për këtë arsye është kërkuar zëvendësimi i trotuareve ekzistuese, do të prishen pothuajse të gjitha shtresat e betonit dhe këto trotuare do të jenë të shtruar me pllaka betoni me trashësi 6 cm.

-Rrjeti I kanalizimeve

Sic e përmendëm edhe më lart, rrjeti ekzistues I kanalizimeve në këtë rrugë është pothuajse tërësisht jashtë funksioni dhe kërkohet ndërhyrje urgjente dhe thelbësore. Për të përmirësuar rrjetin KUZ është parashikuar zëvendësimi I të gjitha tubave ekzistuese gjithashtu edhe I të gjitha pusetave, në këtë mënyrë do të kemi mirëfunksionimin e tij si dhe nuk do të na krijohen efekte të dëmshme për shëndetin dhe pamjen vizuale. Theksohet se realizimi I këtyre punimeve është domosdoshmeri sepse në ditë rreshjesh evitojnë mbi-ngarkimin e kanalit të ujrave të zeza dhe daljen në sipërfaqe të ujrave të zeza sa herë që koha do të jete me rreshje qofshin edhe të nivelit mesatar .

Realizimi Kushteve Teknike:

Shfrytëzimi maksimal i gjurmës së rrugës ekzistuese sipas kërkesave të dhëna në DS, për realizimin e punimeve me kosto sa më të ulët.

Integrimin dhe unifikimin e projektit të këtij segmenti, me gjatësi rreth, $L=165$ m me projektet e pjesëve të tjera.

Realizimin e shpejtësise së projektimit dhe kufizimet përkatëse për shkak të kalimit në zona të banuara dhe në pjesë të veçanta dhe të veshitura.

Sigurinë e lëvizjes së mjeteve dhe këmbësorëve në rrugë, në funksion të terrenit dhe zhvillimit planimetrik, sidomos në zonat e banuara.

Ndërtimi i rrugës me sa më pak prishje e shpronësime që të jetë e mundur. Ruajtja e objekteve të rëndësishme dhe me karakter unikal (që në rrugën tonë nuk ka të tilla).

Plotësimi i kërkesave të përfituesve të fshatrave të zonës, në lidhje me infrastrukturën e nevojshme. Ruajtjen dhe spostimin apo dëmtimin minimal të linjave infrastrukturore ekzistuese, të elektrikut, që intersektojnë rrugën, ose me dëmtim minimal të tyre.

Realizimi i një projekti me kosto sa më të ulët dhe shfrytëzimi maksimal i materialeve të ndërtimit që gjenden në zonën ku do të ndërtohet rruga.

Mbrojtja e Ambjentit dhe dëmtimi sa më pak, gjatë kohës së ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit të rrugës.

Punoi: Ing. Elton Hallulli

